



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

nr. 412, datë 21.04.2016

“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e qerasë financiare dhe në sektorin financiar”

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetare
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetare
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtare
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij, të datës 21.04.2016, me pjesëmarrjen e znj. Lindita Milo (Lati), znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi dhe Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimin e ankesën e Shoqërisë “Muka” sh.p.k mbi disa shqetësime në tregun e qirasë financiare (leasing),

Baze ligjore: Neni 24, germa d), neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e ankesën e Shoqërisë “Muka” sh.p.k mbi disa shqetësime në tregun e qirasë financiare (leasing),

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja “Muka” sh.p.k, ka depozituar një ankesë nëpërmjet së cilës ankohet ndaj “Landeslease” SH.A lidhur me kontratën e sigurimit të automjetit objekt të kontratës së qirasë financiare nr. 1464, nr. 339 rep, nr. 208 kol, të lidhur me datë 31.01.2015 me një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Për procedimin e mëtejshëm mbi trajtimin e ankesës së paraqitur u zhvillua një takim me ankuesin, ku ky i fundit parashtrori shqetësimet e tij lidhur me sjelljen e qiradhënësit “Landeslease” SH.A për sigurimin e automjetit objekt i kontratës “leasing”, si dhe depozitoi dokumentacionin e nevojshme lidhur me të.
3. Sipas ankesës, Muka shpk, me cilësinë e qiramarrësit, ka kryer sigurimin e automjetit objekt i qirasë financiare pranë shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” SH.A, shoqëri e cila nuk është në listën e 4 (katër) shoqërive të miratuara nga qeradhënsi “Landeslease” SH.A. Për këtë arsye kjo “police sigurimi” nuk është pranuar nga “Landeslease” SH.A pasi vjen në kundërshtim me nenin 7

të Kontratës dhe nuk përmbush interesat ekonomike dhe kontraktuale të kësaj shoqërie.

4. Marrëdhëniet që lindin nga kontrata e qirasë financiare (leasing) rregullohen nga Neni 849 i Kodit Civil të RSH, si dhe Ligji nr. 9396, datë 12.5.2005 “Për qiranë financiare”, (i ndryshuar), i cili trajton edhe të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën përkatëse.
5. Veprimtaria e qiradhënies financiare, si dhe të gjitha subjektet financiare jo banka, që kryejnë këtë veprimtari licensohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë (vijim BSH), në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” (neni 126) dhe akteve nënligjore të nxjerra prej saj për këtë qëllim.
6. Nga vlerësimi ligjor i ankesës rezulton se: detyrimi nëpërmjet miratimit paraprak të një numri të caktuar shoqërisht sigurimi nga ana e qiradhënësit, bazuar në çmimin/vlerësimin e kushteve aktuale si të pa favorshme për objektin e qerasë, pa dhënë asnjë argumentim për qiramarrësin, përveçse kufizon lirinë e zgjedhjes së qiramarrësit pa të drejtë, sjell kufizime për konkurrencën në tregjet e lidhura me tregun e qirasë financiare për automjete, duke ndikuar strukturën e tregut dhe sjell përqendrim në tregun e sigurimeve.
7. Një sjellje e tillë mund të sjellë përjashtime me karakter antikonkurrues në tregun e lidhur. Ky përjashtim që bën qiradhënësi duhet të ketë si qëllim që t'i sigurojë qeramarrësit shërbimet më të mira dhe me kosto më të ulët për ta dhe jo t'i imponojë klientit një shërbim me një çmim më të shtrenjtë, kur tregu e ofron këtë shërbim me çmime më të ulta e konkurrese. Parimisht për një funksionim efikas të këtij tregu është e nevojshme që klienti (qiramarrësi) të gëzojë të drejtën që të zgjedhë shërbimin më të mirë për të.
8. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kontrata objekt-ankimimi përmban dispozita të cilat pengojnë zhvillimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në tregun e qirasë financiare dhe ato të lidhura me të.
9. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës vëren se problematika të ngjashme të kufizimit të zgjedhjes konsumatore vihen re edhe në segmente të tjera të tregjeve të shërbimeve financiare, kryesisht në marrëdhëniet bankë-klient-shoqëri sigurimi, dhe vlerëson se liria e zgjedhjes konsumatore duhet të zbatohet në të gjitha rastet nga bankat, shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e tjera që ofrojnë shërbime financiare.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d), nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Shoqëria “Landeslease” SH.A ka detyrimin për ndryshimin e nenit 7, pika 4, të kontratës së qirasë financiare nr. 1464, nr. 339 rep, nr. 208 kol, datë 31.01.2015, duke ja lënë “qiramarrësit” të drejtën e përzgjedhjes së ndërmarrjes

siguruese, me qëllim sigurimin e automjetit objekt- kontrate me çmimin më të mirë të mundshëm.

- II. Bankat e nivelit të dytë, ndërmjetësit financiarë dhe të gjitha shoqëritë e licensuara në sektorin financiar kanë detyrimin t'u sigurojnë klientëve lirinë e zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit për çdo kontratë, duke hequr klauzolat e ekskluzivitetit apo ato përjashtuese në formën shkresore, por edhe në zbatimin real të tyre.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë "Landeslease" SH.A dhe palëve të interesuara, bankave të nivelit të dytë, shoqërive të sigurimit, Shoqatës së Siguruesve dhe Shoqatës së Bankave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

()
Zv/Kryetare

Koço BROKA

()
Anëtar

Iva ZAJMI

()
Anëtare

Eduard YPI

()
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R E